



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA



Me 23.05.2025

Mamushë

Nr. i referencës: 626-24-5207-1-2-1

Në bazë të nenit 105 dhe nenit 26 paragrafi 1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 si dhe nenit 67 paragrafi 67.6 të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022, vendimit të Panelit Shqyrtues të OSHP-s 2025/0212 të datës 16.05.2025 bie këtë :

V E N D I M

I

Anulohet njoftimi B58 i datës 12.03.2025 mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e procedurës së prokurimit, për aktivitetin e prokurimit me nr. 626-24-5207-1-2-1 dhe nr. të brendshëm 626-24-008-1-2-1 me titull: “Furnizimi me material shpenzues për laborator dhe material shpenzues dentar”

II

Lënda për procedurën në fjalë kthehet në rivlerësim sipas rekomandimit të OSHP-s

III

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij.

A R S Y E T I M

Zyra e Prokurimit e Autoritetit Kontraktues - Komuna e Mamushës, me datë 31.05.2024 ka shpallur njoftimin për kontratë me titull: “Furnizimi me material shpenzues për laborator dhe material shpenzues dentar” me nr. të prokurimit: 626-24-5207-1-2-1 dhe nr. të brendshëm: 626-24-008-1-2-1. Pas njoftimit për kontratë dosjen e tenderit e kanë shkarkuar njëzetë e katër (24) Operatorë Ekonomik, ndërsa tenderin e kanë dorëzuar tre (3) prej tyre.

Pas vlerësimit të tenderit në fjalë me datën 12.03.2025 kemi publikuar njoftimin B58 për anulimin e tenderit.

Të pa kënaqur me vendimin e AK-s Operatori ekonomik **“MEDPLUS SH.P.K.”** nga **Prishtina** me datën **17.03.2025** ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim të vendimit të AK-s. Pas shqyrtimit të kërkesës me vendimin **02 nr. 47-25** të datës **20.03.2025** i është refuzuar kërkesa si e pa bazuar.

Të pa kënaqur me vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim Operatori Ekonomik **“MEDPLUS SH.P.K.”** me datën **01.04.2025** ka paraqitur ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP). Pas shqyrtimit të ankesës, Paneli Shqyrtues i OSHP-s me vendimin **OSHP: 2025/0212** të datës **16.05.2025** ka vendosur që të anulojë vendimin B58 të A.K. Komuna e Mamushës të datës **12.03.2025** dhe ka rekomanduar që lëndën ta kthejmë në ri-vlerësim.

Andaj, duke u bazuar në atë që u tha më lartë, në dispozitat e nenit 105 të LPP-s si dhe nenit 67 paragrafi 67.6 të Rregullores për Prokurimin Publik 001/2022 u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Gazmend Gashi
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Mamushës

